



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 180 prot.

Tiranë, më 24.02.2020

Vendim
Nr. 19 datë 21 shkurt 2020

Për zgjedhjen e tre anëtarëve të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe për dy avancime në titullin akademik

Në përmbushje të pikës 1, paragrafët 4 dhe 5 të rendit të ditës, njoftuar me vendimin nr. 10 datë 16.01.2020 të Kryesisë, Asambleja e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 21 shkurt 2020, kreu procedurat e parashikuara në nenet 7 dhe 11 të Statutit për zgjedhjen e tre anëtarëve të jashtëm dhe për dy lëvizje të brendshme (avancim në titullin akademik).

Për administrimin statutor të procesit të votimit Asambleja krijoi me votim të hapur komisionin e posaçëm, të përbërë nga anëtarët e saj: akad. Florian Vila (kryetar), akad. Petraq Petro (anëtar) dhe akad. Jorgaq Kaçani (anëtar).

Referuar rezultatit të shpallur nga komisioni i posaçëm pas numërimit të votave (procesverbali bashkëngjitur), Asambleja:

Vendosi:

I. Fitojnë titullin akademik anëtarët e Asamblesë me titull të mëparshëm akademik i asociuar:

1. Nestor Thereska;
2. Shaban Sinani.

II. Të zgjedhë si anëtarë të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë:

1. Eno Koço;
2. Fioralba Cakoni;
3. Mira Mezini.

III. Për përgatitjen e diplomave, regjistrimin e tyre në *Librin e Artë të Albanologjisë*, caktimin e kalendarit dhe organizimin e ceremonisë së dorëzimit të tyre ngarkohet sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave.

IV. Për shpalljen e vendimit në faqen zyrtare të institucionit ngarkohet punonjësi i marrëdhënieve me jashtë dhe me publikun.

V. Efektet financiare të këtij vendimi për pikën e parë fillojnë më 1 mars 2020.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI

